



KOMUNIKATË PËR MEDIA

Regjistrimi i Partisë Politike: *Demokratska Alternativa - DA*, i hapur për shqyrtim publik

Prishtinë, 11 shkurt 2010 – “Demokratska Alternativa” me akronimin (DA) ka kompletuar kërkesen për regjistrim, të parashtruar nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimi përfundimtar për regjistrim të iniciativës politike do të merret pas përfundimit të periudhës shtatë (7) ditore, gjatë të cilës publiku mund ti shqyrtoj dokumentet e regjistrimit.

“Demokratska Alternativa-DA” është themeluar më 24 janar 2010 nga z. Dragan STOJKOVIĆ dhe sipas programit të saj angazhohet për demokratizimin e shoqërisë në të gjitha sferat e jetës. Për afirmimin maksimal dhe avancimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, barazinë e popujve, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve pakicë si dhe pakicave nacionale në pajtim me normat ndërkombëtare. “Demokratska Alternativa-DA” do të angazhohet për anëtarim të vendit në Bashkimin Evropian dhe në Institucionet tjera Evropiane dhe Evroatlantike. Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ruajtjen e ambientit jetësor, kjo parti rëndësi të veçantë do ti kushtojë familjes e në kuadër të familjes rol të veçantë do të ketë grua. Kurse theks të veçantë do ti kushtojë eliminimit ose se paku zvogëlimit të rasteve siç janë: narkomanija, alkoolizmi dhe dukuri tjera tjera të ngjashme. Të gjitha këto “DA” shpreson ti arrijë në bashkëpunim me forcat tjera demokratike.

Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim i është dhënë përgjegjësia për regjistrimin e partive politike në Kosovë, nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.03/L-073.

Sipas Rregulles së KQZ-së nr.01/2008 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë, *secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë së bashku me çfardo të dhëne apo material që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve kalendarike nga shpallja e kërkesës.*

Të gjitha materialet e regjistrimit duke përfshirë programin e partisë, statutin, dhe shenjën do të jenë në dispozicion për shikim dhe komente nga publiku.

Promovimi i transparences për procesin e regjistrimit të partive politike është pjesë e procesit të KQZ-së.

Zyra për Regjistrim të Partive Politike gjendet në Rr. Agim Ramadani p.n në Prishtinë. Secili që dëshiron ti shikojë dokumentet mund të vijë në Zyrë prej orës **10 - 12** gjatë ditëve të rregullta të punës, nga data 11 shkurt deri më 17 shkurt 2010. Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyren për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim / Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, +381 (0)38 20023006, ose 038/551-807.